



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi a) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. të datës 11.09.2023 kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** si e palejuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Malsijaj Company” Sh.P.K. e datës 11.09.2023 kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHET** operatorit ekonomik “Malsijaj Company” si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**Arsyetim**

Operatori ekonomik “Malsijaj Company” (tutje “parashtruesi”) me datë 11.09.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për dhënie të kontratës të datës 12.06.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe vendbanimeve rurale” me nr. të prokurimit 616-22-11453-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa për rishqyrtim tanimë është trajtuar si përmes vendimit të autoritetit kontraktues të datës 26.06.2023 lidhur me kërkesën për rishqyrtim të datës 19.06.2023 ashtu edhe përmes vendimit të OSHP me nr. 2023/0474 të datës 17.07.2023.

Faqe 1 nga 2

Me datë 13.06.2023 është publikuar B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues përmes të cilit është rekomanduar për kontratë tenderuesi "Select Prima". Ndaj këtij vendimi parashtruesi me datë 19.06.2023 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim ndërsa me datë 26.06.2023 autoriteti kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit e ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Tutje parashtruesi me datë 07.07.2023 ka parashtruar ankesë ndaj vendimit të autoritetit kontraktues ndërsa OSHP me datë 17.07.2023 ka nxjerrë vendimin nr. 2023/0474 përmes të cilit e ka hedhur poshtë si të jashtafatshme ankesën e parashtruesit.

Pretendimet ankimore sipas kërkesës për rishqyrtim të datës 11.09.2023 janë pothuajse identike me ato të kërkesës për rishqyrtim të datës 19.06.2023 si dhe të ankesës në OSHP të datës 07.07.2023.

Duke u bazuar në vendimin e OSHP me nr. 2023/0474, autoriteti kontraktues me datë 05.09.2023 ka publikuar edhe B08 Njoftimin për Dhënie të Kontraktës ndërsa me datë 14.09.2023 është publikuar edhe B52 Njoftimin për Nënshkrimin e Kontraktës. Aktualisht kontrata e nënshkruar është në zbatim e sipër. Me fjalë të tjera kërkesa për rishqyrtim është parashtruar kundër dokumentit të gabuar dhe jashtë çdo afati ligjor. Për më tepër këto pretendime ankimore tanimë janë trajtuar si nga autoriteti kontraktues ashtu dhe nga OSHP përmes vendimit të cituar më sipër.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se kërkesa për rishqyrtim duhet hedhur poshtë si e palejuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafit a dhe b si dhe nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafi 1.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.1 pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1 nënparagrafin a) dhe b) si dhe nenin 60 paragrafin 60.1. nënparagrafin c) të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 18.09.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.